



KUVENDI I KOMUNËS **KOMITETI PËR KOMUNITETE**

Procesverbal nga mbledhja e XVII-të (shtatëmbëdhjetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 09 janar 2024

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkollli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin Fadil Babatinca nga Stacioni i Policisë në Podujevë, përfaqësues të KFOR-it, (lista e pjesëmarrësve)

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj punë të mbarë, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë të gjithë, andaj në vazhdim po i lexoj pikat e rendit të ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 06.12.2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 06 dhjetor 2023.

2. Draft Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, në mbledhjen e kaluar është ngrit një Grup punues / Komision për hartimin e draftit të Planit të Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024. Grupi punues ka punuar dhe e ka përgatitur si propozim ngjashëm me atë të vitit të kaluar përveç disa ndryshimeve të datave dhe vizitave të parapara, për të mos e lexuar gjithë Draftin e Planit po i cekë vetëm ndërhyrjet ku kemi bërë, ato janë:

- Më 05.02.2024 kemi paraparë vizitën në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rrugën “Xhafer Meta” në Podujevë

- Më 04.03.2024 kemi paraparë vizitë në lagjen ku jetojnë komunitetit jo shumicë në rrugën “Ali Ajeti” në Podujevë

- Vizitat nëpër shkollat fillore në fshatrat Batllav dhe Orllan kemi paraparë në muajin Mars, edhe pse datën nuk e kemi caktuar por që do të merremi bisedojmë dhe do të koordinohemi për këto vizita.

- Në muajin Shtator kemi paraparë vizitë në shkollën fillore në fshatin Orllan.

- Vizita në shkollat e mesme të ulëta të qytetit “Naim Frashëri”, “Shaban Shala”, dhe “Dr. Ibrahim Rugova” do të bëhen sipas marrëveshjes tonë si Komitet ngase këto shkolla i kemi afër dhe nuk paraqet ndonjë problem apo angazhim shtesë, kështu që mund t'i realizojmë këto vizita kurdo që merremi vesh ne, prandaj nuk kemi caktuar ndonjë datë.

Gjithashtu kemi paraparë temën për shqyrtimin e mundësive për gjetjen e donatorëve eventuale për sigurimin e lëndëve djegëse për stinën e dimrit për familjet e komuniteteve jo shumicë që jenë me gjendje të rëndë ekonomike dhe në nevojë. Pra këtë çështje do ta shqyrtojmë në Majin Tetor, sepse mund të jetë kohë e gjatë deri sa të shfaqet ndonjë donator i mundshëm për dhurimin e ndonjë sasive të druve për komunitetin jo shumicë në nevojë.

Po ashtu sigurisht jeni në dijeni se kemi pas dhe do të vazhdojmë bashkëpunimin me të gjitha Organizatat jo qeveritare që janë në Komunën e Podujevës dhe më gjerë, Institucionet relevante, Ministrinë për Kthim, Zyrën e Komuniteteve në kuadër të Zyrës së kryeministrit, OSBE-në, KFOR-in dhe të gjitha të tjerat.

Sigurisht që ky plan do të miratohet sot në këtë mbledhje dhe i njëjti do t'ju shpërndalet në mbledhjen e radhës së Komitetit, edhe pse i njëjti pas nënshkrimit do të publikohet në ueb faqe.

Andaj urdhëroni e hapi debatin nëse ka të lajmëruar për të marrë fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri miratohet Plani i Punës së Komitetit për Komunitete sipas materialit të dërguar me thirrjen e mbledhjes dhe plotësim ndryshimeve të paraqitura nga Kryesuesi i Komitetit në emër të Grupit punues për hartimin e Draftit të Planit të Punës së Komitetit për vitin 2024, i ngritur në mbledhjen e Komitetit të mbajtur më 06 dhjetor 2023.

3. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, paraqiti ankesat e një numri të anëtarëve të Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas që në mbledhjen e radhës së Komitetit për Komunitete të jetë prezentë drejtoresha e Qendrës për Punë Sociale-QPS për të shfaqur disa halle të tyre që kanë, apo edhe mund të formojmë një komision që të vizitoj drejtoreshën dhe t'i paraqes ato ankesa dhe kërkesa të dy lagjeve përkatëse të komuniteteve jo shumicë.

Pra meqë nga shumica po përkrahet që drejtoresha e QPS-së të vije këtu në mbledhjen e Komitetit dhe të dëgjojë ankesat dhe disa probleme të shfaqura në komunitete lidhur me ndihmat sociale për të cilat po konkurrojnë / aplikojnë në mënyrë që të shtjellojmë disa rregulla ligjore dhe disa çështje që ata nuk po mund të jenë përfitues, apo për të na informuar lidhur me ankesat rreth ndarjes së ndihmave financiare për familjet / anëtarët e Komuniteteve të cekura që jetojnë në Komunën e Podujevës.

Si përfundim mbetet që Kryesuesi i Komitetit për Komunitete të diskutoj këtë çështje me drejtoreshën QPS-së dhe t'i bëjë ftesë për pjesëmarrje në mbledhjen e radhës së Komitetit për Komunitete, me qëllim të informimit dhe dhënies së përgjigjeve rreth subvencioneve / dhënies së ndihmave financiare për personat e komuniteteve jo shumicë që janë raste sociale dhe me nevoja tjera të ngjashme.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:25

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0002234/24
Podujevë, 09 janar 2024**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**